

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SYNTRADE" SH.P.K

Sot, më datë 25/12/2024 **Z. Kristaq Qurku**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/11/1980, lindur në Gjirokaster, dhe banuese në Tiranë, Rruga Eduart Mano, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal ID: I01118013T vendos të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1
Themelimi

Emri i shoqërisë është "**SYNTRADE**"SH.P.K" Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**SYNTRADE**"SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2
Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter tregëtar dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin "**SYNTRADE**"SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4
Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është:

- Importimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore në përgjithësi, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, importimin dhe tregtimin e produkteve me origjinë bimë dhe shtazore dhe nënprodukteve të tyre: të freskëta, të ngrira të konservuara dhe sido qofshin të përgatitura apo të konfeksionuara, edhe bimë mjekësore, prodhime industriale, metale të ndryshme, ushqimore, agrikulturës, prodhime ferme, lëndë të para, materiale druri dhe mobilje;
- Do të ushtrojë veprimtaritë e shitblerjes, të marrjes ose të dhënies me qera të pasurive të luajtshme të atyre të paluajtshme si ndërtesa ose pjesë të tyre të çdo lloji,



troje dhe godina, ose veprimtari të tjera të ngjashme brenda kësaj fushe. Ka të drejtë të kryejë çdo lloj veprimtarie industriale.

- Tregtimi, prodhimi dhe përpunimi, si dhe operacione dhe transaksione për importimin, eksportimin, tranzitimin, dhe tregtimin e mallrave të ndryshëm me shumicë e pakicë, të makinerive, pajisjeve teknologjike dhe linjave të prodhimit, në industrinë e lehtë dhe ushqimore. Mund të ushtrojë veprimtari të tjera tregtare dhe gjithashtu mund të japë ose të përfitojë leasing, franchising, garanci dhe gjithashtu të kryejë çdo lloj veprimi tjetër tregtar me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, veprime financiare si dhe çdo veprim tjetër tregtar të nevojshme dhe të dobishëm për realizimin e qëllimeve të objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

- Mund të ushtrojë veprimtari në fushën e transporteve duke realizuar blerjen dhe shitjen jashtë dhe brenda vendit të mjeteve të transportit, të kategorisë së lehtë dhe atyre të rëndë. Shoqëria mund të kryejë transport, distribucion, marrje porosie nëpër klientë të produkteve ushqimore, produkteve jo ushqimore, farmaceutike dhe çdo lloj produkti tjetër për llogari të kompanive të treta sipas marrëveshjes që do të lidhet.

- Idejim, krijim, prodhim reklamash. Organizim promocionesh. Ideim, dizejm, printim kartvizitash, ftesash, flete-palosjesh, e.t.j. Organizim dhe zhvillim i trajnimeve në fushën e marketingut. Ofrimi i shërbimit të manaxhimit të krizave në shoqëritë private dhe shtetërore, duke përfshirë dhenien e asistencës, shërbime teknike dhe shkencore, ose krijimin e lehtësirave për çdo institucion shtetëror, bashki ose lokalitet, privat, organizata, shoqëri, person juridik ose çdo autoritet tjetër dhe kryerja e marrja përsiper ekzekutimi dhe kontrolli i çdo projekte përfitim për publikun si dhe çdo projekt tjetër, sipërmarrje, studim, kerkim, me ose dhe pa shpërblim. Ofrimi i shërbimit të marketingut për çdo kategori prodhuesi, për çdo prodhues artizanal, profesionist, ofrues marketingu etj. Ofrimi dhe zhvillimi i trajnimeve mbi konceptet e operimit "KNOW HOW", pasurive industriale dhe intelektuale, patentave dhe markave, Përvetësimi dhe shitja ose dhurimi i "KNOW HOW", ose dhe çdo gjeje që ka lidhje me këto lloj aktiviteti ashtu si kryerja e tregëtisë ose përdorimi i çdo lloj "KNOW HOW". Kryerjen e biznesit të reklamave, agjent reklamash.


- Shoqëria, me qëllimin e vetëm për të arritur objektin e shoqërisë, mund të kryejë të gjitha operacionet në fushën e ndërtimit, industrisë, tregtisë, pasurive të patundshme dhe financiare që lidhen me objektin e shoqërisë, ose që kanë lidhje me të; mund gjithashtu të kontribuojë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, por gjithmonë me qëllimin e vetëm për arritjen e objektit të shoqërisë dhe jo në mënyrë mbizotëruese, me pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri të tjera dhe kompani me objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të dhe mund të lidhë kredi hipotekimi edhe fondesh dhe të japë gjithashtu garanci dhe hipoteka në favor të palëve të treta.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në: Xhafzotaj, Nr. 344, Fllake, pranë mbikalimit Durrës, Shqipëri.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, me 1 (nje) kuote me vlerë nominale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare "SYNTRADE" SH.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Z. Kristaq Qurku**, Z. Kristaq Qurku, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/11/1980, lindur në Gjirokastrë, dhe banuese në Tiranë, Rruga Eduart Mano, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal ID: I01118013T zotëruar i 1 (një) kuote të përbërë nga 100.000 (njëqind mijë) lek, duke përfaqësuar 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.


Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Kristaq Qurku**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/11/1980, lindur në Gjirokastrë, dhe banuese në Tiranë, Rruga Eduart Mano, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër personal ID: I01118013T.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11



Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortaku detyrohet të ruajne sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduqojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.


NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga OrtakuThemelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje.

Ky Akt-Themelimi hartohet në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Z.Kristaq QURKU

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Kristaq Qurku', with a large, sweeping circular flourish underneath.